



Pranimi / Dostizanje / Prilaz / Pasdafa / Recepcion / Delivery	04-03	1	viti / god / year
Organizuesia / Organizacion / Org / Unit	Prof No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKRIMSJK	969/2021		112



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr.64/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**—Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani - kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-anëtare dhe Zyle Millaku-Gojnovci-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.64/2021 të parashtruar me datë 05.02.2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokati \_\_\_\_\_ për ankuesen \_\_\_\_\_ me adresë, Rruga "Fehmi Agani", Nr.138/5 në Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Infrastrukturës, në çështjen juridike "Transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin I nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin I nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.03.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV** i iniciuar me ankesën A.Nr.64/2021 të datës 05.02.2021 të parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja \_\_\_\_\_ e punësuar në Ministrinë e Infrastrukturës në pozitë: "Udhëheqëse e Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës", e cila me datë 05.02.2021 ka parashtruar Ankesën me numër A.Nr.64/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 22.12.2020 me numër 10242 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, për transferimin e ankueses në një pozitë tjetër ekuivalente.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.02.2021 ankesën e ka proceduar tek Ministria e Infrastrukturës. Me datë 16.02.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Infrastrukturës, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datë 01.03.2021 ankuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit \_\_\_\_\_ ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 861/2021 për tërheqjen e ankesës të parashtruar në Këshill, kundër Vendimit numër 10242 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, të datës 22.12.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 511/2021 të datës 05.02.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit i datës 22.12.2020 me numër 10242 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës; E-mail i datës 06.01.2021; Vendim i datës 10312 i datës 24.12.2020 për pushim të



lehonisë; Kërkesë për tërheqje e datës 01.03.2021 me numër protokoll 861/2021; Përgjigje në ankesë e datës 16.02.2021; Akte emërimi i datës 16.11.2018 me numër protokoll 10765; Kërkesë për pushim e datës 23.12.2020; Vendimi i datës 04.12.2020 me numër protokoll 2959/2020 i Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.77/2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses **është bërë i pamundur sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja me datë 05.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 511/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 01.03.2021 ka parashtruar kërkesën me numër protokoll 861/2021 për tërheqjen e ankesës së datës 05.02.2021 të parashtruar në Këshill, kundër Vendimit të datës 22.12.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, me numër protokoll 10242, lidhur me transferimin e ankueses në një pozitë tjetër ekuivalente, me rastin e zbatimit të Vendimit të datës 04.12.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër A.nr.77/2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të kërkesës së datës 01.03.2021 për tërheqje e ankesës së datës 05.02.2021, të parashtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar Av.Engjëll Rexhepi, ka konstatuar se kërkesa për tërheqje është e drejtë e ankueses, të përcaktuar në dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"**, në këtë rast Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.64/2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- përfaqësuesit të autorizuar Av.
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

